



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:143063

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06189844

C.nr.551/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, në përbërje prej gjyqtarit Zenel Tasholli, gjyqtar individual, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.. D.. nga fsh.Sh.., K.L.., të cilin me autorizim e përfaqëson av. M..G..me seli në L..., kundër të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Lipjan, me objekt kontesti kompensim i të ardhurave në bazë të inflacionit dhe kualifikimit, jashtë seance gjyqësore, më dt. 20.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

- I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadija e paditësit Sh..D.nga fsh.Sh.., K.L..si e bazuar dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t’ia paguaj në emër të kualifikimit për përgatitje profesionale në lartësi prej 27% diferencën shtesë në pagë bazë për periudhën 02.07.2018 – 31.01.2023 për 55 muaj kalendarik shumë e përgjithëshme prej **3,044.25-€** si dhe shtesa pagë në emër të shkallës së inflacionit për periudhën 10.03.2019 – 21.11.2022 shumë prej **832.74-€** të gjitha këto shuma me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë dt.0 2.07.2021 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET** e paditura që paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 248.00€ në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

E autorizuar e paditësit, me datë 02.07.2021, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i diferencës në shtesë në pagë në emër të kualifikimit.

Me padi, ka theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës në Sh.F.M.U. “I..B..” në fsh. Sh.. ku vazhdon të punojë edhe sot. Me parashtrësën për zgjerimin e dt.10.03.2022 ka bërë zgjerimin e padisë në kuptimin objektiv duke kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që në bazë të nenit 35 par.10 të KAK-së t’ia paguaj paditësit kompensimin në emër të shtesës në pagë në bazë të inflacionit.

Me parashtrësën për precizim të dt.08.07.2024 ka theksuar se sa i përket kërkespadiës, paditësi është me diplomë fakulteti për të cilin fakt i takon shtesa e të ardhurave personale apo 27% e pagës bazë në muaj edhe atë, në përputhje me Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK), ndërsa e paditura e ka paguar atë vetëm 58.32-€, duke i mbetur borxh nga 55.35-€ për muaj, nga gjykata ka kërkuar që në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për kualifikim, për periudhën nga data 02.07.2018-31.01.2024, t'ia paguajë shumën 3,044.25€, si dhe shtesën në pagë në bazë të shkallës së inflacionit për periudhën 10.03.2019 – 21.11.2022 në shumë prej 832.74-€ si dhe kamatën nga dita e paraqitjes së padisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, përkatësisht shumën 104.00-€ për përpilimin e padisë, për precizimin e kërkespadiës shumën prej 104.00-€ dhe për taksën gjyqësore për padi.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi. E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të parashtruar më datë 21.02.2023 e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadiës dhe se sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit 03/L-212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditëses nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive në nenin 46, par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditurës nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive, ndërsa sa i përket kualifikimit paditësja e merr kualifikimin në bazë të dispozitave ligjore të përcaktuara nga Thesari i Kosovës e që në rastin konkret vihet në përfundim se komuna nuk e ka legjitimitetin real pasiv lidhur me pagesën shtesë për kualifikim, por ajo është kompetencë e nivelit qendror. I ka propozuar gjykatës që konform dispozitave ligjore të LK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditëses ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Nga përgjegje në padi dhënë nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditur, mirëpo kontestuese është kompensimin i mjeteve në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për shtesën në pagën bazë në bazë të inflacionit dhe shtesës në pagë në emër të kualifikimit për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe ajo në vazhdimësi dt.22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK-ut, ku me dispoziten e nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, parashihet se dispozitat e kesaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit parauniversitar (para shkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, Shkolla Speciale e Qendra të Kompetencës) dhe Institucione të Arsimit të lartë

në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtar të SBASHK-ut, dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit ne sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD te Universiteteve e institucioneve te arsimit te larte, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private ne mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Gjykata ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese, se paditësja është mësimdhënëse e kualifikuar me fakultet, paga bazë e të cilës është 421.00-€, ndërsa nga e paditura është kompensuar vetëm pjesërisht apo më saktë vetëm nga 58.32-€ në muaj, duke i mbetur kështu borxh nga 55.35€ për muaj, fakte këto të mbështetura kontrata e punës nr.prot.04-112-813/.. e datës 01.09.2019, Lista e pagave lëshuar nga BQK, licenca numër .., e dt. 10.12.2012 dhe diploma numër 379, e lëshuar më dt. 18.03.2015 nga Universitetit i Prishtinës “H..P..” – Fakulteti i Edukimit me titull bachelor i biologjisë – kimisë, prova këto vendimtare për vendosje në këtë çështje kontestimore, pasi janë lëshuar nga organi kompetent, këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës, duke provuar kështu saktësinë e thënieve në këto dokumente, ashtu siç është paraparë në nenin 329.1 të LPK-së.

Gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor sepse, themelësia e kërkesëpadisë bazën ligjore e ka në dispozitat e nenit 55, par. 1 të Ligjit të Punës, i cili ka përcaktuar se: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, par. 5 i cili ka përcaktuar se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive” dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021; nenin 35, par. 10 sipas të cilit është përcaktuar: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”. Dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit e vitit 2017 aplikohen edhe për periudhën Janar 2019– 20.01.2021, ndërsa pas kësaj date ato të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.01B/2056 dhe për Vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022.

Me dispozitën e nenit 7 të KKAK-së parashihet: “*Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shpëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit*”, dhe atë: pika 1.3 “*mësimdhënës me diplomë 3 dhe 4 vjeçar 27% e pagës bazë*”, ndërsa pika 1.4, parasheh “*mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magjistraturë/master dhe doktoraturë 35 % e pagës bazë*”.

Në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të datës 29.08.2008, në fuqi deri me datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik nr. 08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësit, drejtorët, zëvendës drejtorët dhe bashkëpunorët profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike 19 %, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjeçar 35 % dhe me diplomë të 5 vjeçare, master dhe doktoraturë 35 % të pagës bazë. Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit/licencimit, është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 214/2023, të datës 05.10.2023.

Me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021; nenin 35, par. 10 sipas të cilit është përcaktuar: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit e vitit 2017 aplikohen edhe për periudhën Janar 2019– 20.01.2021, ndërsa pas kësaj date ato të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.01B/2056 dhe për Vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022.

Lidhur me lartësinë e kompensimit sa i përket inflacionit, gjykata ka vendosur duke u bazuar në parashtrësën për precizimin e padisë të autorizuarit të paditëses te dt.03.06.2024, pasi që të njëjtat janë dhënë, e në veçanti duke marr parasysh pagën që paditësja ka realizuar. Për më tepër kalkulimi i këtyre shumave është bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ashtu siç përcaktohet edhe në nenin 35 paragrafi 10 të KKAK-së, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë për pagën bazë të paditëses në shumë prej 421.00€, e duke llogaritur shkallën e inflacionit, për vitin 2019 prej 2.7%, për vitin 2020 prej 0.2%, për vitin 2021 prej 3.4% dhe për vitin 2022 në shkallë prej 11.6%.

Poashtu, kjo gjykatë vlerëson se paditëses i takon e drejta e kompensimit në emër të kualifikimit diferencën shtesë në pagë bazë prej 27% për periudhën nga dt.02.07.2018-31.01.2023 për çdo muaj shumen prej 55.35€ apo shumën e përgjithëshme prej 3,044.25€ për 55 muaj si dhe në emër të shkallës së inflacionit për periudhën nga dt.10.03.2019-21.11.2022 shumën prej 832.74€ të gjitha këto shuma me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në përmbushjen definitive të detyrimit

Poashtu me nenin 8 të LMD-së, ku thuhet se *“Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditëses.

Poashtu poqëse e paditura e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t’i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete parashtrësës së përgjigjes në padi, me të cilat do ti vërtetonte pretendimet e saj.

Andaj, meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës lidhur me faktin e zbatimit ose jo të kontratës kolektive, gjykata i gjeti të pa bazuara këto pretendime, pasi në rastin konkret baza juridike e kërkesës së paditësit buron nga Vendimi i Qeverisë. Edhe pretendimin se paditësja është pranuar në punë sipas këtij kualifikimi dhe në kontratën e saj të punës përcaktohen përqindjet sipas kualifikimit, për gjykatën ishte fakt jo relevant për këtë çështje kontestuese pasi përqindjet sipas kritereve të licencimit të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë dhe në kontratë të punës kanë dallim mes vete dhe mësimdhënësit nuk kompensohen sipas këtyre kritereve. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të palës së paditur se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë dhe se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk e obligon të paditurën,por nivelin e pushtetit qendor, pasi që vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedhë se obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura, andaj edhe ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë e paditur në procedurën konkrete kontestimore dhe në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj

kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, iu referua nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilave paditëses ju pranohen shpenzimet procedurale dhe atë ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit t'ia kompensojë në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 104.00-€ në emër të parashtrimit të padisë, për parashtrësë për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 104.00-€, sipas TOAK-së si dhe shumë prej 40.00-€ në emër të taksës gjyqësore, e në total shuma prej 248.00-€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.551/2021, datë 20.09.2024

Gj y q t a r i
Zenel Tasholli

Udhëzim juridik:

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.